



USAID | **KOSOVO**
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



**MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT
(MM)**

NË MES TË

**AGJENCISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
(USAID)**

DHE

KOMUNËS SË PRISHTINËS

**LIDHUR ME PROJEKTIN PËR KOMUNA TRANSPARENTE, EFEKTIVE DHE
LLOGARIDHËNËSE (TEAM)**

DUKE PASUR PARASYSH se synimi i Misionit të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë, përmes partnerit të saj zbatues DAI Global LCC (DAI), është që të bashkëpunojë me komunën e Prishtinës (Komuna) (secilës i referohemi si Palë, dhe kolektivisht Palët) për të zhvilluar dhe për të vënë në funksion një model për komuna transparente, efektive, dhe llogaridhënëse, për të angazhuar nivelin qendror në adresimin e korrupsionit komunal në procesin e prokurimit, dhe për t'ia bërë të mundur shoqërisë civile që të gjurmojë dhe ekspozojë korrupsionin në nivelin komunal.

DUKE PASUR PARASYSH se qëllimi i USAID-it është që përmes partnerit të saj zbatues DAI të bashkëpunojë me Komunën për të rritur transparencën, efektivitetin dhe llogaridhënien e Komunës në fushën e prokurimit, e-prokurimit, menaxhimit financiar, auditimit të brendshëm, dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; dhe

DUKE PASUR PARASYSH se qëllimi i Komunës është që të bashkëpunojë me DAI-n për të përmirësuar transparencën, efektivitetin dhe llogaridhënien në procesin komunal të prokurimit, auditimit të brendshëm, menaxhimit financiar, dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; dhe

PËR KËTË ARSYE, TANI, Palët kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

1. QËLLIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MM) është që të përkufizojë parimet udhëzuese të bashkëpunimit në mes të USAID-it, përmes partnerit të saj zbatues DAI, dhe Komunës, si dhe të përshkruajë pritjet e të dy pjesëmarrësve. Si USAID-i, përmes partnerit të saj zbatues DAI, ashtu edhe Komuna zotohen për respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë: sundimi i të drejtës, transparenca, llogaridhënia, efikasiteti, efektiviteti, përgjegjshmëria, përfshirja dhe pjesëmarrja e qytetarëve. Rrjedhimisht, Palët e kanë bërë këtë Memorandum të Mirëkuptimit (MM) për të përcaktuar veprimet e propozuara të tyre lidhur me mbështetjen e tyre për arritjen e këtij qëllimi.

2. SFONDI

USAID-i ka krijuar projektin Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhëse (TEAM), i cili është një projekt pesëvjeçar i dizajnuar të mbështes Qeverinë e Kosovës (QK) në zbatimin e reformave kundër korrupsionit, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e prokurimit komunal në të 38 komunat e Kosovës, si dhe ofrimin e ndihmës gjithëpërfshirëse për pesë komunat që janë në fokus. Projekti TEAM do të zbatohet nga kontraktuesi amerikan, DAI Global LLC, për të arritur qëllimin e tij përmes mentorimit, trajnimit dhe udhëzimit të përditshëm, duke krijuar kështu sisteme të cilat do të përmirësojnë llogaridhënien për fondet dhe shpenzimet publike.

3. FUSHAT E ASISTENCËS TEKNIKE

Projekti TEAM i USAID-it do të adresojë nevojat e Administratës Komunale dhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës pas një vlerësimi të bazuar në analizën e nevojave për trajnim, i cili do të mundësohet nga DAI. Ndihma e veçantë që do të ofrohet nga DAI në zbatimin e projektit TEAM do të specifikohet në Planin Komunal të Punës, për të cilin do të pajtohen Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe DAI. Plani Komunal i Punës është përshkruar gjerësisht në Pjesën 4 të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

4. VEPRIMET E USAID-it

USAID-i, përmes partnerit të saj zbatues DAI, synon që t'i ofrojë Komunës mbështetjen e mëposhtme:

- **Asistencë të përshtatur teknike** që ofrohet përmes mentorimit dhe trajnimit në vend të punës lidhur me ciklin e prokurimit, përfshirë planifikimin e projektit, dizajnimin dhe dokumentimin e projektit, planifikimin e kërkesave për oferta, tenderimin, vlerësimin e ofertave, dhënien e kontratave, kontabilitetin dhe auditimin, përpilimin dhe menaxhimin e kontratave, e-informatat, e-ofertimin, e-tenderimin, dhe të gjitha fushat e tjera të ciklit të prokurimit, duke krijuar në këtë mënyrë mekanizma mbrojtës kundër korrupsionit gjatë gjithë procesit.
- **Ndërtim të kapaciteteve** për rritjen e transparencës komunale, forcimin e zyrave komunale të prokurimit për të përdorur sistemin e prokurimit elektronik (e-prokurimin), ndërtimin e kapaciteteve të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit të komunave mbi prokurimin, rritjen e kapaciteteve për kodet e etikës dhe masat e veçanta kundër korrupsionit për zyrtarët e prokurimit, dhe/ose për nevojat e tjera prioritare të identifikuara në planet e zhvillimit të kapaciteteve komunale.
- **Trajnim** bazuar në analizën e nevojave për trajnim që do të përfshijë trajnimin për e-prokurim për të gjithë zyrtarët e prokurimit, sektorin privat dhe OSHC-të, zyrat e auditimit të brendshëm, si dhe trajnimin e ndërmjetëm dhe të avancuar të prokurimit, duke mbuluar tema të tilla si prokurimet me vlerën më të mirë, trajnimet për menaxhimin e ndryshimeve për kryetarët e komunave dhe krerët e departamenteve të prokurimit, informimi dhe komunikimi publik, komunikimi dhe angazhimi i mediave, angazhimi i shoqërisë civile, etika, integriteti i qeverisë, transparenca, dhe prioritetet e tjera të identifikuara në planet e zhvillimit të kapaciteteve komunale.
- **Rritjen e mbështetjes, bashkërendimit, dhe bashkëpunimit** me subjektet e nivelit qendror (siç janë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Ministria e Financave, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Njësia Qendrore e Prokurimit, Njësia e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, etj.) që janë të rëndësishme për mbështetjen, monitorimin dhe ofrimin e mbikëqyrjes së komunave në fushën e prokurimit, duke përfshirë e-prokurimin, menaxhimin financiar, auditimin, dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.
- **Rritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal** për të monitoruar komunat, në fushat si prokurimi dhe rekrutimi, duke përdorur dhe analizuar informatat që janë të disponueshme publikisht për të krijuar fletënotime, për të nxjerrë në pah korrupsionin, dhe në përgjithësi, për të hedhur më shumë dritë mbi qeverisjen komunale dhe proceset e prokurimit.
- **Numër të kufizuar të granteve të vogla** për aktivitete të vogla me ndikim të lartë në nivelin komunal që promovojnë transparencën dhe llogaridhënien. Këto aktivitete do të kërkojnë një kontribut komunal prej të paktën 20% të vlerës totale të grantit.

5. VEPRIME E KOMUNËS

Nga ana e saj, Komuna synon:

- **T’ia mundësojë qasjen** stafit të DAI-t në drejtoritë komunale, në komisionet e kuvendit komunal, dhe të sigurojë që stafi të merr pjesë dhe të mbështes aktivitetet e projektit TEAM. Kjo përfshin qasjen në të gjitha dokumentet e brendshme komunale sipas nevojës.
- **Të marrë pjesë në programet e trajnimit, në zhvillimin e kapaciteteve, dhe në aktivitetet e asistencës teknike** të organizuara nga partneri zbatues i USAID-it DAI dhe të shpërndajë praktikën më të mira komunale dhe mësimet e nxjerra tek komunat që janë dhe që nuk janë në fokus.
- **Të inkurajojë bashkëpunimin me kohë të zyrtarëve komunalë** në kryerjen e aktiviteteve të nevojshme, duke siguruar qasje në të gjitha të dhënat dhe informatat e kërkuara.
- **Të zhvillojë dhe të zbatojë planet komunale të punës** bashkë me DAI-n duke vënë në shënjestër nevojat komunale dhe kërkesat për arritjen e suksesit të matshëm.
- **Kontribut komunal** prej të paktën 20 për qind për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta në nivel komunal që promovojnë transparencën dhe llogaridhënien.
- **Të ofrojë një mjedis të favorshëm për stafin e DAI-t** duke caktuar hapësirë të dedikuar në Komunë për specialistin komunal të projektit.

6. BASHKËRENDIMI DHE KONSULTIMI

Palët duhet t’i ofrojnë njëra-tjetrës informatat që janë të nevojshme për të mundësuar ofrimin e asistencës së përcaktuar në këtë memorandum dhe për të vlerësuar efektivitetin e asistencës. Palët gjithashtu duhet të takohen periodikisht për të shqyrtuar asistencën e përcaktuar këtu dhe për të shkëmbyer informatat relevante. Çdo çështje në lidhje me interpretimin, administrimin apo zbatimin e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit duhet të zgjidhet përmes konsultimit në mes të Palëve.

7. DISPOZITAT E PERGJITHSHME

A. Efekti i MM-së. Ky MM nuk përbën obligim ligjor apo marrëveshje detyruese dhe nuk përbën obligimin e fondeve nga USAID-i apo nga Qeveria e SHBA-së, dhe nuk nënkupton transferimin e fondeve nga USAID-i te Komuna e Prishtinës apo marrje të detyrimeve nga ana e USAID-it. USAID-i obligohet, zotohet, shpenzon fondet dhe kryen punët në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme të Shteteve të Bashkuara.

B. Instrumentet e palës së tretë dhe disponueshmëria e fondeve. Me qëllim të ofrimit të asistencës së përshkruar në këtë MM, USAID-i mund të hyjë në kontrata dhe instrumente të tjera me palë publike dhe private, përfshirë DAI Global LLC, ashtu si e konsideron të udhës USAID-i. Këto janë instrumente, që pasi të ekzekutohen plotësisht, do të përbëjnë detyrime ligjore për USAID-in. Tërë asistencë dhe puna e USAID-it sipas këtij MM varen nga

disponueshmëria e fondeve dhe marrëveshja e mëtejshme në mes të USAID-it dhe palëve të tilla publike e private lidhur me ofrimin e asistencës së tillë. Meqë asistenca dhe veprimet e USAID-it nga kjo marrëveshje mund t'i nënshtrohen instrumenteve të tjera të tilla detyruese, në rast të ndonjë konflikti në mes të termave të atyre instrumenteve dhe kushteve në këtë MM, do të mbizotërojnë termat e instrumenteve tjera. Asnjë palë e tretë nuk mund të kërkojë të drejta në bazë të instrumenteve të tilla si palë e tretë përfituese, edhe nëse ajo palë e tretë mund të përfitojë nga asistenca e ofruar nga cilido instrument i tillë.

C. Publiciteti. Palët duhet t'i japin publicitetin e duhur asistencës së përcaktuar këtu si program në të cilin ka kontribuar USAID-i. Ky publicitet përfshin shenjëzimin e mallit, të punishteve të ndërtimit dhe objekteve të ndërtuara sipas udhëzimit nga USAID-i. Palët synojnë të bashkëpunojnë në publikimin e rezultateve të aktiviteteve në pajtim me këtë MM në mënyrë të duhur dhe në përputhje me rregullat e USAID-it për brendim dhe shenjëzim, të cilat mund të gjenden në: www.usaid.gov/branding.

D. Marrëdhënia me marrëveshjen bilaterale kornizë. Çdo asistencë që mund të ofrojë USAID-i do të jetë pjesë e programit të Qeverisë së SHBA-së për ndihmë për Kosovën në bazë të Marrëveshjes për Bashkëpunim Ekonomik dhe Teknik në mes të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 29 mars 2012, dhe Marrëveshjes së ndryshuar dhe të ri-theksuar për ndihmë në mes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës të datës 2 shtator 2010, e ndryshuar më pastaj, dhe i nënshtrohet kushteve dhe termave të këtyre Marrëveshjeve, përfshirë edhe dispozitat për lirim nga tatimet dhe detyrimet doganore.

E. Shqyrtimi dhe pezullimi i Marrëveshjes. Gjatë rrjedhës së projektit TEAM, Palët do të koordinojnë dhe bashkëpunojnë ngushtë me njëra-tjetrën. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi i tillë do të përfshijë, ndër të tjera, një shqyrtim formal të progresit. Në qoftë se, si pjesë e këtij procesi, Komuna:

1. tregon mungesë të përkushtimit për rezultat të suksesshëm të Planeve komunale të punës të rëna dakord; ose
2. është gjetur të jetë duke punuar në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi,

DAI rezervon të drejtën të pezullojë punën e vet në Komunë dhe do t'ia komunikojë këtë pezullim, me shkrim, Komunës. Rifillimi i punës së DAI-t do të ndodh pasi Komuna t'i ofrojë DAI-t prova të mjaftueshme, me shkrim, të planit të saj dhe korrigjimit të më pastajmë të çdo defekti apo mangësie që ka çuar në pezullim.

F. Ndryshimet dhe dhënia fund. Ky MM mund të ndryshohet apo modifikohet me shkrim nga Palët. Secila Palë mund të ndërpresë pjesëmarrjen në këtë MM duke i dhënë Palës tjetër një njoftim me shkrim prej tridhjetë (30) ditësh.

G. Data e hyrjes në fuqi dhe kohëzgjatja. Ky MM hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe mbetet në fuqi deri më 10 janar 2022.

H. Përfaqësuesit. Palët do të përfaqësohen nga personat që mbajnë ose janë ushtrues detyre në pozitat e mbajtura nga nënshkruesit e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit. Secila Palë, përmes njoftimit me shkrim të palës tjetër, mund të identifikojë përfaqësues tjerë të autorizuar për ta përfaqësuar atë Palë për të gjitha qëllimet, përveç atyre për ekzekutimin e ndryshimeve formale të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit. Secila Palë duhet të njoftojë tjetrën me shkrim për ndryshimet e përfaqësuesve të autorizuar.

I. Gjuha. Ky MM është përgatitur në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Në rast të paqartësie apo konflikti në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

NË PRANINË E DËSHMITARËVE, Palët, secila duke vepruar përmes përfaqësuesit të autorizuar, e nënshkruan këtë Memorandum të Mirëkuptimit në emër të vet dhe e bën efektive më _____ **Maj 2017.**

AGJENCIA E SHTETEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

James Hope
Drejtor i Misionit/Kosovë

KOMUNA E PRISHTINËS

Shpend Ahmeti
Kryetar i Komunës

Halim Halimi
Kryesues i Kuvendit të Komunës